



Raport

Program trajnimi

**MENAXHIMI URBAN
PËR PLANIFIKIM TË QËNDRUESHËM URBAN**

**Kitakyushu, Japoni
16-29 Tetor 2016**

Luan NUSHI

Instituti për Planifikim Hapësinor
Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor



Vendi: Japoni
Qyteti Kitakyushu
Data: 16 – 29 Tetor 2016
Organizatori: JICA – Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar
Programi – “Menaxhimi Urban për Planifikim të Qëndrueshëm Urban”

Përfaqësues nga niveli qendror i planifikimit të shteteve në zhvillim: Shqipëria, Kosova; Timori Lindor, Gjakarta, Mianmar, Laos, Tajlanda dhe Irani.



Foto e pjesëmarrësve, profesorëve dhe përgjegjësve të programit: (në këmbë nga e majta): BERE LOEC Simao, nga Timori Lindor; KUNVITAYA Arkarlat, nga Tajlanda; MONGPHACHAN Somvan, nga Laosi; JAFARKARIM Ashkan, nga Irani; NUSHI Luan, nga Kosova; MALI Fiona nga Shqipëria; CHOTIWATESILP Jutarut, nga Tajlanda; Mya Yi Mon, nga Mianmar; Wina nga Gjakarta; (ulur nga e majta) prof. Uchida, Universiteti në Kitakyushu; z. Katyama, Drejtor i aeroportit në Kitakyushu; Dr. Ueno, Kitakyushu; z.?, përfaqësues i lartë i Jica-s; z. Taksaki, udhëheqës i kursit; Dr. Tokumura, Jica; dhe znj. Mofumi administratore dhe përkthyes, Jica.

Qëllimi kryesor: Njohja me praktikat japoneze në fushën e menaxhimit urban si përvojë për aplikimin e tyre në shtetet pjesëmarrëse.

Vërejtje: Raporti është rezultat i shënimeve të marra nga ligjëratat dhe materialet e ofruara, ndërsa fotot e prezantuara në raport, janë origjinale dhe të realizuara gjatë vizitave në terren.



Të dhëna elementare për Japoninë

- Emri origjinal i Japonisë është Nipon, që do të thotë “Sun origin” ose “origjina e diellit”;
- Japonia është pjesë e Kontinentit të Azisë, ujdhesë e rrethuar nga Deti Japonez në lindje dhe Oqeani Paqësor në perëndim;
- Japonia përbëhet prej 6.852 ujdhesave;
- Pika më e lartë e Japonisë është Mali Fugji me 3.776 mlmd;
- Popullsia - më tepër se 127 milion banorë (regjistrimi i vitit 2012);
- Kryeqyteti - Tokio, ndërsa qytetet tjera të mëdha janë Osaka, Nagoya, dhe Sapiro;
- Gjuha zyrtare - japonishtja;
- Japonia shtrihet në të ashtuquajturin “rrethin e zjarrtë të Paqësorit”, në të cilin ndodhen disa vullkane dhe ndihen vazhdimisht dridhje të tokës (tërmete);
- Pjesa më e madhe e Japonisë (3/4) janë male dhe pyje;
- Samurajtë janë ushtarët historik të Japonisë, luftëtarë të shkathët, arma kryesore e të cilëve ka qenë Katana, shpata e mprehtë dhe e lakuar në maje.
- Japonia është njëri nga shtetet më të zhvilluara industriale, në të cilën prodhohen lloje të ndryshme të makinave me teknologji të avancuar;
- Disa nga kompanitë më të njohura botërore janë: Toyota, Honda, Sony, Nintendo, Canon, Panasonic, Toshiba, Sharp, etj.;
- Sumo është sporti kombëtar i Japonisë, ndërsa sporti më i popullarizuari është sporti i baseballit.
- Japonia ka qenë nikoqir i disa ngjarjeve sportive botërore: Lojërat Olimpike Verore në 1964 në Tokio dhe përsëri do të mbahen në vitin 2020; Lojërat Olimpike Dimërore 1972 në Sapiro dhe më 1998 në Nagano.
- GDP - 38,633.71 USD (2013)
- Flamuri Japonez - me fushë të bardhë, në qendër të të cilës është një rreth i kuq që simbolizon diellin. Në gjuhën japoneze flamuri quhet Hinomaru, që do të thotë “rrethi i diellit”. Në anglishte ndonjëherë përkthehet si “lindja e diellit”. Zyrtarisht është përvetësuar si flamuri mbretëror i Japonisë më 27 Janar 1870.



Përmbajtja dhe zhvillimi i kursit

Akomodimi dhe detajet për rregullin shtëpiak.

Detajet e shpjeguara nga zyrtarja që na pranojë ishte përvoja e parë me të cilën vërtetohen menjëherë ndryshimet në qasje dhe në mentalitet. Të gjitha informatat ishin të shkruara me shumë detaje, duke përfshirë edhe ato më banalet (hapja dhe mbyllja e derës, përdorimi i tualetit, përdorimi i ujit, përdorimi i makinës për larjen dhe hekurosjen e rrobave dhe detaje tjera), por patjetër ato duhet edhe të thuheshin dhe sidomos të merrej dakordimi me to.

Vendosja në Qendrën e Jica-s, në një dhomë solide (për nga funksioni dhe përmbajtja më e mirë se dhoma në hotelin e Vjenës). Problemi i parë është gardëroba, e cila nuk përputhej me parashikimet dhe rekomandimet paraprake (gjysma e panevojshme ose jo e përshtatshme). Problemi tjetër serioz ishte ushqimi i cili edhe për nga përmbajtja, shija por edhe pamja dukej krejtësisht ndryshe. Në çdo racion orizi ishte përbërësi i zakonshëm, me të cilin me kalimin e kohës fillon të ushtroresh.

Problem tjetër me rëndësi është teknologjia me të cilën është bukur vështirë të përshtatësh. Telefonat nuk punojnë në sistemin japonez (zgjidhja është vetëm nëse e merr aparatit me qira, ka shërbime që e ofrojnë këtë mundësi). Unë personalisht lidhjen e vetme të mjaftueshme e kam pas përmes Skupe dhe adresës zyrtare të e-mail-it të instaluar në dhomë.

Dita e parë e programit

Kafja e mëngjesit në dhomën time me pamje nga një pjesë e mirë e qytetit dhe me kohë të ndryshueshme, momentalisht me diell.

Aktualisht jam në përgatitje për ngrënien e mëngjesit, i cili sipas asaj që e pash mbrëmë është shumë i ndryshëm nga mëngjeset që jemi mësuar - ta shohim;

Mund ta konfirmoj se për ushqim jemi më mirë se Japonia, shumica e asaj që ofrohej ishte për kriteret tona pa shije dhe shumë pak frymëzuese. Shërbimi mesatar, i nivelit të kampusit studentor i cili realizohej nga një staf në pamje shumë i moshuar. Sipas pjesëmarrësve me përvojë, kjo do të jetë oferta e përditshme gjatë gjithë programit.

Njohja me pjesëmarrësit dhe rregullat e programit

Sot ishte dita e parë formale e punës në programin e JICAs – “Urban Management for Sustainable Urban Development”.

Si zakonisht në fillim njohja me pjesëmarrësit, organizatorin dhe rregullat e kursit;

Pjesë e grupit janë përfaqësues të disa shteteve si: Shqipëria (Fijona Mali, zyrtare në Agjencinë e Zhvillimit të Territorit të Shqipërisë); përfaqësues edhe nga Timori Lindor; nga Tajlanda; nga Irani; nga Laosi; nga Mianmar dhe unë nga Kosova;

Hapja e programit

Programi formalisht u hap nga z. Joshinori Takasaki - lider i programit, i cili foli për përvojën e deritashme me JICAn dhe mënyrën e ndryshimit dhe adaptimit të programeve sipas kërkesave të identifikuara dhe orientimin që kanë zgjedhur për programin në fjalë. Programi që po fillojmë ka një afat të shkurtë dhe nuk është e mundur që për të gjitha problemet e paraqitura të ofrojmë zgjidhje. Do të bëjmë përpjekje që problemet të përmbledhim dhe të fokusojmë, në mënyrë që zgjidhjet e ofruara nga ekspertët e JICAs të mund të jenë të aplikueshme në vendet tuaja. Për ta arritur këtë na duhet ndihma e secilit prej jush, na duhet korrektësia dhe përkushtimi i juaj që bashkërisht të gjejmë zgjidhjet më të mira.

Këtë radhë në program e kemi futë edhe analizimin e dy pilot projekteve të realizuara në Japoni, konkretisht në Kitakyushu. Njëri ka të bëjë me mjedisin dhe tjetri me rrjetin e hekurudhës mono-brinjësh. Materialet e ofruara flasin për procesin e projekteve në fjalë dhe detyra e dy grupeve të formuara do të jetë nxjerrja e çështjeve kyçe dhe përpjekja që ato të merren parasysh në raste të ngjashme.

Disa nga temat e programit

Përgatitja e Planit të Veprimit - Ligjërata e Dr. Maskatsu Ueno

Programi vazhdojë me pjesën tematike që kishte të bënte me përgatitjen e planit të veprimit, i cili do të përgatitet nga të gjithë pjesëmarrësit në fund të programit. Secili prej nesh duhet të prezantoj planin e veprimit që do të përgjigjet problemeve të deklaruara në aplikimin tonë formal për pjesëmarrje në program. Prof. Ueno ishte ligjëruesi i parë i cili në mënyrë shumë simpatike e shtjellojë punën e planit të veprimit. Duke i marrë shembull problemet e paraqitura

nga pjesëmarrësit u kuptua se pjesa dërmuese e tyre janë shtruar në mënyrë jo të duhur (shprehje më e butë nga ajo gabimisht). Problemet mund të grupohen në tri grupe: në grupin ku paraqitet vetëm problemi (i tej zgjatur dhe shumë kompleks) pa propozimet për përmirësim; në grupin e dytë janë pjesëmarrësit që e kanë bërë përzjerjen e problemit gjithashtu të zgjeruar me ndërhyrjet për përmirësim; dhe grupi i tretë i pjesëmarrësve të cilët nuk e kanë të qartë as problemin dhe si rezultat as veprimet për përmirësim.

Mënyra më e mirë për zgjidhjen e problemit është definimi i tij, sipas profesorit instrumenti bazik për zgjidhjen e problemit është qarku i ashtuquajtur P-D-C-A (Plani – Realizimi – Kontrolli – Veprimi).

Qarku përbëhet prej katër fazave:

1	Plani	Identifikimi dhe analiza e problemit. Të gjendet problemi i vërtetë Të përcaktohet cakt & 5W2H Në mes situatës së dëshiruar dhe gjendjes aktuale të problemit është një hapësirë e pa trajtuar si duhet. Formula e mësipërme është mënyra më e mirë për trajtimin e duhur. Why? – është W1 që paraqet forcën shtytëse/arsyeja; What? – është W2 që paraqet titullin e problemit/punës/veprimit; How to? – është H1 që paraqet metodën/technikën e realizimit; How much? – është H2 që paraqet buxhetin e nevojshëm; Who; Where dhe When – janë W3, 4 dhe 5 që varën nga lloji dhe përmasat e projektit.
2	Realizimi	Të ndërmerren veprimet në harmoni me planin.
3	Kontrolli	Krahasimi në mes nivelit të planifikuar dhe rezultatit. Nëse identifikohet lëshimi/gabimi duhet të analizojmë rezultatit në mënyrë që të bëjmë korrigjimet e nevojshme të planit; Nëse nuk ka lëshime/gabime të qarta, duhet të promovohet dhe të insistohet në vazhdimin dhe përfundimin e Planit.
4	Veprimi	Të zbatohen veprimet e korrigjuara; Të ndërmerren veprimet bazuar në qëllimin që parashihet në fazën e dytë.
Përmirësimet e nevojshme mund të bëhen nëse çarku do të përsëritej deri në përfundimin e Planit.		

Mësimi elementar i gjuhës japoneze

Vazhdimi i programit të sotëm me dy orë mësimi të gjuhës japoneze – ishte shumë relaksues. Përpjekja për ti prononcuar fjalët në gjuhën japoneze na sillte shpesh në situata shumë qesharake (Koninchiwa – pasdite e mirë – good afternoon). Edhe tash kur po e shkruaj raportin po qeshem me vetete me situatën e krijuar, me insistimin e profesoreshës për ta bërë prononcimin si duhet dhe përpjekja ime që ta ndryshoj “q” me “sh” ishte e pamundshme (situata nuk mundet të shkruhet, duhet të tregohet). Fatkeqësisht këto ishin të vetmet orë të gjuhës japoneze që ishin parashikuar në program.

Prezantimi i Qytetit të Qëndrueshëm

(Letër dërguar kolegëve në IPH. Po ju shkruaj me dëshirë që të ndajë me ju një konstatim, që gjithsesi ka me qenë pjesë e raportit nga vizita im në Japoni. Fjala është për mentalitetin dhe përkushtimin që po e hasi gjatë këtyre ditëve të qëndrimit tim në Japoni, konkretisht pas prezantimit të njërit nga ligjëruesit e sotëm.)

“Ligjërues Mr. Katayama, me një përvojë shumë të madhe, aktualisht shef i aeroportit në Kitakyushu. Një prezantim shumë përmbajtjesorë dhe me shumë detaje, që tregon mburrjen, përkushtimin dhe seriozitetin për ti arritur qëllimet e parashtruara përpara vetvetes. Kjo është mrekullia vet, kur po e krahasoj me situatën në Kosovë po më vjen të qajë (mos me thonë nja send tjetër). Nuk e kemi as ma të voglin durim që gjërat ti shtyjme përpara, nuk e kemi të qartë që 17 vite se, jemi Ne ata që duhet ti bëjmë dhe nuk ka tjetër. Me çfarë mburrje prezantohej gjendja nëpër të cilën ka kaluar vendi (Japonia e ka humbur Luftën e Dytë Botërore me shumë dëme) dhe çfarë durimi dhe përkushtimi kanë treguar dhe po tregon i gjithë populli, për ta ndërtuar dhe zhvilluar vendin, është e pa imagjinueshme për ne. Ne jemi “në gjumë”, të pa interesuar për gjërat që lidhen me shoqërinë dhe shtetin, por shumë “të kfillt për dreqnillyke”. Ky është dallimi në zhvillim, në mes Japonisë dhe vendit tonë të lodhtë. Shpesh e kam dëgjuar shprehjen se, shumë shpejtë do të bëhemi si Japonia, ose pyetjen “Qysh me u ba si Japonia??!!” – Shumë vështirë, mbase kurrë, nëse nuk e ndërrojmë qasjen!. Duhet më së pari ta përmirësojmë veten, e mandej shtetin tonë. Për ne solidariteti si koncept është zhdukë, ndërsa ky qenka akoma njëri nga atributet kryesore të Popullit Japonez, për të cilët edhe ideali ekziston akoma. Ai është zhvillimi dhe dashuria pa kushte e vendit, të cilin që të gjithë: pushtetarë, profesionistë dhe të tjerët, e konsiderojnë si shtëpinë e tyre. “Mirë për të tjerët, mirë për mua, mirë për shoqërinë – mirë për të gjithë” - kjo është motoja të cilës i besojnë të gjithë. Fatkeqësisht për ne krejt çka është jashtë derës së shtëpisë nuk është e jona, për të duhet të kujdeset dikush tjetër!!!. Është koha që të bëjmë hapin e duhur, ta ngrisim nivelin e përgjegjësisë dhe dashurisë ndaj vendit, të fillojmë të rindërtojmë ndjenjën për “të përbashkëtën” dhe të mos ngushtohemi vetëm rreth veprimeve “mirë vetëm për mua”.

Jam shumë i sigurt se edhe vendi edhe ne e meritojmë më shumë.”

Luani



Foto nga ligjërata

Qyteti Kitakyushu është njëri nga 20 qytetet që kanë një status të veçantë dhe bashkë me 47 prefekturat përbëjnë ndarjen kryesore hapësinore të shteti të Japonisë.



Gjatë zhvillimit të tij si qytet, ka përjetuar disa ulje dhe ngritje. Fillimisht në vitin 1870 Kitakjushu ka qenë një vendbanim me disa fshatra të vogla dhe pa perspektivë të qartë. Politika e atëhershme e shtetit që kishte për synim ngritjen e mirëqenies dhe forcimin e ushtrisë bëri që në këtë qytet të vendoset njeri nga regjimentet e njohura të ushtrisë Japoneze. Ky ishte momenti i kthesës dhe i zhvillimit të shpejtë të kësaj zone dhe të qytetit në veçanti. Për nevoja të ushtrisë u ndërtua porti detar, në afërsi të të cilit u vendosë hekurudha. Dhe në këtë mënyrë filloj interesimi i kompanive për të hapur bizneset e tyre, që krijuan kushte për jetë më të mirë jo vetëm për banorët vendas por edhe për shumë të tjerë që erdhën nga të gjitha vendbanimet përreth.

Ulja e parë ka ndodhë si pasojë e zhvillimit të transportit ajror në qytetin Fukuoka, në të cilin filluan të zhvendosen të gjitha kompanitë që vepronin dhe ishin burim i mirëqenies për shumë familje.

Ngritja e dytë ka ndodhë pas viti 1985, kur u krijua një vizion i qartë për zhvillimin e qytetit u hartua i ashtuquajtur i Plani për Ringjallje. Me të cilin ju dha përparësi zhvillimit të industrisë së turizmit dhe si rezultat u hartua plani për Eko Qytetin. Sfida për ringjallje ishte karrem për të marrë më shumë fonde nga niveli qendror, me të cilat fillojë ndërtimi i qendrave të reja të biznesit duke ndikuar kështu në ngritjen e serishme të interesimit të kompanive dhe bizneseve.

Evaluation Pr - Kita

Param.	Prishtina	Kita Kyushu
Popull.	400.000 B	1.000.000 B
Buxh. Vjetor	50.000.000.000	5.000.000.000
Buxh. Vjet. per Buj.	250 \$/B	5000. \$/B

Sipas informuatore të i muoveu gjate ligjërates, uq bslite raporti i amnubitive.

Pjesë e prezantimit ishte edhe rasti i veçantë për përmbytjet që i ka shkaktuar lumi në një pjesë të qytetit të mbushur plot me ndërtime ilegale dhe pa plan adekuat. Sot kjo zonë është njëra nga pjesët më të bukura të qytetit, për realizimin e të cilit janë deshtë 20 vite me plotë angazhim.

Financimi dhe buxheti i qytetit Kitakyushu ishte pjesa tjetër e rëndësishme e prezantimit. Sipas të cilit shihet se qyteti me përmasë të qytetit të Prishtinës ka një buxhet prej hiq më pak se 5 miliardë dollarë.

Foto e krahasimit tim te buxhetit Pr.-Kita.


Gjendja aktuale e sektorit të banimit

Duke u bazuar në Monitorimin statistikor të tokës dhe banimit në vitin 2013 gjendja është si më poshtë:

Numri total i njësive të banimit	Të banueshme	Të pabanuara	Nuk janë për banim
496.630	425.470	71.160	27.940
100%	85.7%	14.3%	5.6%

Koncepti evropian i qëndrueshmërisë

E ndodhur karshi fenomenit të rritjes negative të popullsisë, Evropa përpara se të gjitha shtetet tjera të botës mund të ofrojë një zgjidhje të mirë të daljes nga kjo situatë. Një përpjekje mund të shpjegohet me skemën e mëposhtme:



Çka është qyteti i qëndrueshëm?

- Qyteti që mund të ofrojë kualitetin e nevojshëm të jetës për qytetarët e vet pa e dëmtuar qëndrueshmërinë e vendbanimeve tjera përreth;
- Qyteti që mund të vazhdojë investimet për me qenë atraktiv për qytetarët e vet duke i përdorë avantazhet dhe potencialin e vet në mënyrë të qëndrueshme;
- Qyteti që zhvillimin e vet e realizon duke e ruajtur mjedisin në mënyrë që natyra dhe hapësira ku jetojmë të jetë e qëndrueshme.

Cilat janë shenja e qytetit të qëndrueshëm

- Kur qytetarët mburren dhe i besojnë qytetit të tyre;
- Kapacitetet mirëmbahen dhe përdoren;
- Ndihma që mund ti ofrohet ngritjes së kapaciteteve për qytetet tjera që kanë nevojë;
- Hulumtimi për zhvillim edhe atëherë kur zhvillimi është maksimal.

Planifikimi urban në Kitakyushu

Ligjërues Dr. Akira Uchida, zv. Drejtor në Institutin për Strategji Rajonal, që vepron në kuadër të Universitetit Publik në Kitakyushu.

Planifikimi urban ishte - tema e profesorit të cilin me pyetje të shpeshta nuk e lejuam ta përfundojë ligjëratën. Gjatë shpjegimeve u kuptua se definicioni për planifikimin urban në Japoni është i njëjti me atë në Kosovë. PU ka për qëllim të bëjë shfrytëzimin e planifikuar të tokës për territorin e caktuar përmes kufizimeve që janë në të mirë të të gjithë banorëve që jetojnë në të. E gjithë zona administrative e Qytetit Kitakyushu është e shpallur me Ligj të Planifikimit të Qytetit si zonë urbane dhe ka një sipërfaqe afërsisht prej 48.865 Ha. Zona në fjalë është e ndarë në dy zona tjera: në Zonën e promovimit urban dhe në Zonën e kontrollit urban.



Foto e profesorit nga ligjërata

Fillimisht Zonimi propozohet nga zyra përkatëse e Qytetit, për të cilin Vendimi përfundimtar për përcaktimin e zonave merret nga Qyteti (autoritetet vendimmarrëse përkatëse). Paraprakisht propozimi kontrollohet nga Këshilli i Ekspertëve (pjesë e të cilit është edhe profesori), në një proces ku janë të përfshirë të gjitha palët e interesit.



Prezantimi i raporteve të pjesëmarrësve

Sesioni i paradites ishte ndarë për prezantimet e raporteve nga puna që secili pjesëmarrës në program është përgjegjës. Prezantimi im kishte të bënte me ndërlidhjen në mes PHKsë dhe zhvillimeve të parapara për zonat urbane, me fokus në zonën ku bënë pjesë Qyteti i Prishtinës. Cilat kanë qenë parashikimet?; Cili është trendi i zhvillimit?; dhe Cilat janë pasojat e zhvillimeve të deri tashme!? Prezantimin e kam përfunduar me disa rekomandime për hapat që duhet të ndërmerren nga niveli lokal për të qenë në harmoni me kërkesat e kornizës së re ligjore në fushën e planifikimit hapësinor. Sipas kërkesës së programit kam veçuar njërin nga problemet që aktualisht sektori ynë është duke u ballafaquar. Fjala është për “zbatimin” si njëra nga hallkat e rëndësishme të sistemit tonë, e cila fatkeqësisht nuk është në nivelin e duhur. Cila do të jetë mënyra dhe cilat do të jenë rekomandimet, do të jetë preokupimi im me të cilin do të merrem gjatë fazës së punimit të planit të veprimit, që do të jetë pjesa e fundit e programit. Problemi i zbatimit ishte pjesë përbërëse e shumicës së prezantimeve që u shfaqën sot nga shtetet pjesëmarrëse në program. Pjesë shtesë e planit të veprimit do të jetë hartimi dhe monitorimi i instrumenteve të planifikimit hapësinor dhe urban.


JICA

Urban Management for Sustainable Urban Development

Spatial and urban development challenges in Kosovo/Prishtina

Luan NUSHI
Institute for Spatial Planning
MESP/KEPA

JICA - Kitakyushu, Japoni, 16-29 10 2016



Pjesë e shkëputur nga prezantimi i raportit tim

Metodologjia e planifikimit të qëndrueshëm

Ligjërues prof. Nakamoto me temën për Metodologjinë e planifikimit të qytetit të qëndrueshëm. Cilat janë masat që janë ndërmarrë që Kitakyushu sot të quhet Qytet i Qëndrueshëm?

- Veprimi i parë duhet të jetë zvogëlimi i diferencës në mes të asaj që është dëshiruar dhe asaj që ka qenë gjendja ekzistuese e qytetit; dhe
- Të bëhet e qartë ideja e zhvillimit për të gjithë;

Ky parakusht me shumë emocione u ilustrua përmes shembullit të Luftës së Dytë Botërore përkatësisht luftës në mes Japonisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Gjenerali i atëhershëm i Ushtrisë Japoneze Yamamoto e përpilon strategjinë për luftë, në të cilën parashihen tre hapa kryesor: 1. Shpallja zyrtare e luftës kundër SHBA-ve; 2. Taktika – sipas të cilës duhet të sulmohet qyteti bregdetar dhe portin e mirënjohur Perl Harbour; dhe 3. Të vazhdohet lufta me mjete tjera luftarake. Gabimi fatal i Gjeneralit ishte se nuk e kishte bërë të qartë strategjinë për të gjithë. Bombarduesit japonez e sulmojnë SHBA-në duke e shkatërruar qytetin dhe një pjesë të forcës ajrore amerikane. Të ngazëllyer pilotët kthehen pas, pa e ditur se ky veprim ishte i pakoordinuar dhe se humbjet e shkaktuara ishin shumë të vogla për ushtrinë e fuqishme amerikane. Ky sulm i befasishtëm dhe poshtërues ndikojë në ngritjen e moralit të ushtrisë amerikane për të ndërmarrë sulmin, rezultatin e të cilit të gjithë e dimë.

Projekti i Aeroportit në Kitakyushu – afati për implementimin ishte afërsisht 20 vite, duke llogaritur edhe kohën afërsisht prej 5 viteve sa është dashtë për debate publike dhe bindjen e pjesëmarrësve në proces. Sot aeroporti në fjalë ka një bilanc shumë pozitiv dhe faktor i rëndësishëm në zhvillimin e përgjithshëm dhe të qëndrueshëm të Qytetit Kitakyushu.

Pas shpjegimeve të nevojshme dhe pyetjes se cili është mendimi për Aeroportin e Gjakovës – natyrisht nga kjo pozitë nuk besoj se do të mund të jap një përgjigje të saktë. Por, ajo që do të bëja së pari është hulumtimet e nevojshme për kërkesat në vend dhe në rajon për shërbime të udhëtarëve dhe mallrave (kost-benefit). Ndoshta aeroporti mundet me qenë i përshtatshëm të shërbejë si servis për riparimin e avionëve; aeroport për ushtrimin e pilotëve dhe ushtrimeve ushtarake; aeroport alternativ me ndonjë tjetër në afërsi. Një mundësi e mirë dhe shumë moderne është që aeroporti të përdoret vetëm për LCS (low cost services), ka shumë udhëtar që i ndjekin këto lloje të aeroporteve.

Tregimi për Mbretin Kinez dhe Sunshin (samuraj i njohur i kohës) dhe kërkesa e mbretit që ai të merrej me ushtrime ushtarake të luftëtarëve të Mbretit. Nëse do të fitohej lufta Sunshi do ti ketë të gjitha privilegjet e mundshme të kohës. Në mesin e luftëtarëve kishte edhe femra, pjesa më e madhe e tyre ishin të dashurat e Mbretit. Sunshi jep urdhër që të vriten të gjitha femrat sepse sipas tij ishin pengesë e ushtrimeve. Ky veprim bëri që luftëtarët e mbetur të jenë më serioz dhe të respektonin të gjitha urdhrat e Sunshit dhe lufta të fitohej. Mbreti e arriti qëllimin dhe Sunshi i fitoi privilegjet e premtuara.

“Qëllimi është që të arrini në maje, zgjedhja është e juaja që të gjeni rrugën më të përshtatshme, vetëm mos e gaboni majën (qëllimin)”.

Administrimi komunal i mbeturinave

Ishte tema në vazhdim, gjatë të cilës konfirmohej rëndësia që ka kjo hallkë e rëndësishme në sistemin e përgjithshëm të menaxhimit të qëndrueshëm të një qyteti/komune.

Qëllimi është ruajtja e epitetit “qytet i qëndrueshëm” përmes një qasje pro aktive ku do të përfshihen të gjitha palët e interesit: qytetarët, shoqëria civile, OJQ-të dhe qeveria komunale. Bazë për këtë do të jetë Plani dhjetëvjeçarë 2011-2020 sipas të cilit është paraparë arritja e këtyre synimeve:

Sasia e mbeturinave për kokë banori në ditë	
Në v. 2009: 506g	Në v. 2020: 470g ose më pak
Shkalla e riciklimit	
Në v. 2009: 30.4%	Në v. 2020: 25% ose më pak
CO2 emisionet të shkaktuara nga trajtimi i mbetjeve	
Në v. 2009: 122.000t-CO2	Në v. 2020: 100.000 t-CO2 ose më pak

Collection boxes (16places)

Used cooking oil always to be brought to the predetermined box
(The city installs collection boxes and bear the cost for treatment.)



“Kjo mënyrë nuk është e përshtatshme për ne, sepse vajin (e kuzhinës) e përdorim disa herë deri sa t’ia nxjerrim yndyrën krejt!”.

Transporti publik në Kitakyushu

- Popullata në Kitakyushu ~1.000.000
- Numri i njësive të banimit~ 420.000
- Shkalla e mplakjes 25.1%??
- Sipërfaqja ~500 km²

Transporti publik është njëri nga funksionet me ndikimin më të madh në statusin e qytetit të qëndrueshëm. Sot në Kitakyushu janë në funksion të gjitha llojet e transportit dhe të gjitha me bilanc pozitiv të zhvillimit. Ky nivel është arrit me angazhim dhe përkushtim të të gjitha strukturave vendimmarrëse të qytetit, të cilët për bazë e kanë pas Strategjinë për rigenerimin e transportit publik të v. 2008.

Foto nga terreni – njëra nga rrugët e zakonshme të qytetit me sinjalistikën e nevojshme.



Sipas kësaj strategjie dhjetëvjeçare (2009-2018) është kërkuar themelimi i një sistemi të ri të transportit publik që do të ofrojë të gjitha llojet e transportit dhe të cilat në mënyrë të sigurt do të shfrytëzohen nga qytetarët.

Strategjia është udhëheqë nga një komitet i përbërë nga përfaqësues të qytetarëve; industrisë; operatorët transportues; dhe administrata e qytetit. Komiteti është takuar vetëm 5 herë për të nxjerrë përfundimisht një Plan të Veprimit shumë pragmatik dhe konkret, pjesë e të cilit janë 234 projekte. Në evaluimin e fundit që i është bërë realizimit të deritashëm të strategjisë, është vërtetuar se nga numri i përgjithshëm i projekteve: janë realizuar 47 ose 20.1%; në progres janë 170 ose 72.6%; të pafilluara ende 7 ose 3% e projekteve dhe në fazën e studimit janë pjesa e mbetur prej 10 ose 4.3% e projekteve.

Autobusët hibrid – janë njëri nga atraksionet të cilin me shumë mburrje e prezantonin. Është teknologji e cila realizohet me kombinimin e energjisë elektrike dhe naftës dhe me imitime minimale të gazrave ndotës.

Pjesë e transportit publik është edhe hekurudha, e cila në Kitakyushu është e disa formave. Nëpër qytet kalon treni më i shpejtë japonez “Shinkanse” që e lidhë të gjithë gati të gjithë Japoninë (pjesë e programit ishte një udhëtim prej Fukuoka deri në Kitakyushu – një përjetim shumë i veçantë). Treni një binarësh është gjithashtu pjesë e transportit publik, i cili e përshkon një pjesë të qytetit duke u mundësuar udhëtarëve udhëtim të qetë, të përshtatshëm, e duke pasur parasysh mënyrën e lëvizjes (treni lëvizë nëpër shtylla të cilat kalojnë mbi të gjitha rrugët e qytetit) edhe shumë i shpejtë. Arsye e përzgjedhjes së kësaj forme të transportit publik është çmimi tre herë më i lirë nga çmimi i ndërtimit të metrosë (1 km/80mil.euro i trenit një binarësh).



Foto e Stacionit Kokura, njërit nga stacionet e trenit njëbriarësh

Hidrogjeni si karburant – ka filluar të përdoret dhe shumë shpejtë do të bëhet lëndë djegëse më e preferuara. Momentalisht është në funksion vetëm për vetura, por në të ardhmen do të aplikohet edhe për mjetet e transportit publik. Gjatë diskutimit dhe prezantimit të problemeve të transportit publik në Kosovë, nga profesori u paraqit mundësia për aplikim në fonde evropiane për avancimin e transportit publik. “Nëse Kosova është njëri nga shtetet më të pasura në botë me thëngjill, nga i cili sipas teknologjive të sotme prodhohet gazi i hidrogjenit, atëherë është shumë e mundshme që të përfiton nga kjo pozitë. Donatorët janë shumë të gatshëm që të ofrojnë përkrahje për këto qëllim. Ju duhet të përgatitni projektin, ti parashtroni kërkesat e qarta dhe unë jam i sigurt që reagimi do të jetë pozitiv. Shfrytëzimi i gazit të hidrogjenit si lëndë djegëse për transportin publik do të jetë njëra nga format më të përparuara të së ardhmes, prandaj shfrytëzoheni” - ishte rekomandimi i profesorit.

Plani i veprimit

Plani i veprimit ishte pjesa finale e programit e cila përfundojë me prezantimet e ideve të të gjithë pjesëmarrësve. Në bazë të ligjëratave dhe materialeve të shpërndara gjatë programit, secili pjesëmarrës ka pasur për detyrë që to ofrojë zgjidhje për problemin e përzgjedhur. Më poshtë e keni skemën e shkëputur nga prezantimi i planit tim të veprimit, i cili për temë kishte problemin e zbatimit të planeve në sektorin e planifikimit hapësinor dhe urban në Kosovë. Skema e mëposhtme është përmbledhje e veprimeve të cilat do të ndihmojnë në ngritjen e nivelit të zbatimit të planeve. Prezantimi dhe përmbajtja e planit të veprimit u pranua shumë pozitivisht nga të gjithë pjesëmarrësit duke përfshirë edhe panelin vlerësues të përbërë nga profesorët e angazhuar për këtë qëllim.

Action Plan

5W2H	Contents
What	Implementation improvement of spatial and urban planning instruments
Why	There are different plans adopted but no proper evaluation procedure to measure implementation. Many Municipalities have adopt them just to fulfill law requirements. In many cases plans are not respected, situation in the field das not correspond with planning objectives.
How to	1. Legal framework amendment; Adaption of an administrative instruction regulating this issue; Organization of trainings for municipal authorities; Promotion campaign – if possible pilot project; 2. Establishment of advisory body in both levels of spatial planning sector; Body role and responsibility; Organizational structure; 3. Setup of evaluation methodology; Establishing of the Integrated measurement system; Preparation of the basic list of indicators;
How much	No additional costs
Who	Central government authority
Where	Entire country
When	Next year legal planning strategy of the Ministry

Pjesë e shkëputur nga prezantimi i planit të veprimit tim

Konkluzion

Jica – është agjenci shtetërore e Japonisë e cila është njëra nga agjencitë që me vite të tëra ka ofruar dhe po vazhdon të ofrojë ndihmë për të gjitha shtetet në zhvillim. Një ndihmë të tillë në forma të ndryshme e ka dhënë dhe po vazhdon ta jep edhe për Kosovën. Një rast i tillë ishte edhe Kursi “Menaxhimi Urban për Planifikim Urban të Qëndrueshëm”, në të cilin morën pjesë përfaqësues nga disa shtete, duke përfshirë edhe Kosovën.

Konstatim i përgjithshëm ishte se në krahasim me kohëzgjatjen, programi i kursit ishte shumë i ngjeshur, me tema të ndryshme, të prezantuara nga ligjërues shumë profesional dhe kompetent. Duke qenë se ky ishte viti i parë i këtij lloji të kursit, u konstatua se ka edhe gjëra që duhet të përmirësohen. Problemi i vetëm serioz që u prezantua nga unë, ishte niveli përfaqësues i pjesëmarrësve (u pranua edhe nga vet organizatorët). Pjesa dërmuese e pjesëmarrësve përfaqësonin nivelin qendror të qeverisjes, ndërkohë që në ligjërata trajtoheshin temat nga qeverisja lokale. Më e mira do të ishte sikur të gjitha shtetet pjesëmarrëse prezantohen me përfaqësues nga të dy nivelet e qeverisjes, e cila sipas organizatorit mund të aplikohet qysh në kursin tjetër të radhës.

Sido që të jetë, personalisht jam i kënaqur me temën dhe mënyrën e trajtimit të sajë dhe për të cilën jam i sigurt se kemi nevojë shumë. Për dy javë qëndrimi në Japoni u organizuan një mori ligjëratash, diskutimesh dhe vizita të ndryshme në terren, u organizuan takime formale dhe joformale me njerëz nga shtete dhe kultura të ndryshme, të cilat janë padyshim një përvojë e veçantë të cilën ua rekomandoj të gjithëve.

Luan NUSHI, Drejtor
Instituti për Planifikim Hapësinor
AMMK/MMPH